



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 08.05.2025
Numër Protokolli: 3267/2025

A.nr.517/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.517/2025, të datës 21.03.2025, të parashtruar nga ankuesi A.K, kundër organit të punësimit/Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.451/2025, e datës 21.03.2025, e parashtruar nga ankuesi A.K.

A r s y e t i m

Ankuesi, A.K. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 21.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur, Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit, të shpallur sipas Konkursit me numër reference RN00015833, më datë 21.11.2024, nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për pozitën e punës *Drejtor i Departamentit të Arsimit Para Universitar*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 21.03.2025, **është e palejuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 21.11.2024, ka shpallur konkursin me numër reference RN00015833, për pozitën

e punës *Drejtor i Departamentit të Arsimit Para Universitar*, me afat aplikimi nga data 22.11.2024 deri më datë 21.12.2024.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 20 kandidatë, ndërsa prej tyre, kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në liste të ngushtë 10 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi, i cili sipas shkresave të lëndës rezulton se nuk ka marrë pjesë në vlerësimin profesional të kandidatëve, përkatësisht në testin me shkrim.

Ndërsa, sipas Njoftimit me Nr.20 të datës 24.02.2025, të Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, rezulton se kandidatja A.K, me gjithsejtë 85.6 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimit, është shpallur kandidate fituese për pozitën e punës *Drejtor i Departamentit të Arsimit Para Universitar*.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër rezultateve përfundimtare të vlerësimit, pretendon se procedura e rekrutimit është zhvilluar përmes shkeljeve procedurale dhe ligjore, që kanë ndikuar në paanshmërinë dhe objektivitetin e procesit të zgjedhjes, duke theksuar ndër të tjera se përbërja e Komisionit të Pranimit ishte në kundërshtim me nenin 45 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ashtu që kërkon rishikimin e përbërjes së Komisioni të Pranimit, anulimin e rezultateve dhe gjithë procesit, qasjen në dokumentacionin e plotë të emërimit të Komisionit përkatës si dhe garantimin e një procesi transparent dhe pa favorizime në përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të ardhshme.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 4 ku përcaktohet se: “4. *E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimit në shërbimin civil*”, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se “*Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative*”, nenit 103 paragrafi 2, ku përcaktohet se: “2. *Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohej, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë*”, si dhe nenit 124 paragrafi 1, të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: “*Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim*”, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se me zhvillimin e procedurës përkatëse të rekrutimit, gjegjësisht shpalljen e kandidates fituese dhe përbërjen e Komisionit të Pranimit, i cili ka vlerësuar kandidatët në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015833, ankuesit nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik lidhur me kandidimin e tij për pozitën *Drejtor i Departamentit*

të Arsimit Para Universitar, ngase i njëjti duke qenë se ka kaluar fazën e verifikimit, sipas shkresave të lëndës, përkatësisht përmes e-mailit të datës 30.01.2025, konstatohet se është ftuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore i MASHTI, për mbajtjen e testit me shkrim të datës 04.02.2024, mirëpo edhe pse i njëjti e ka konfirmuar pranimin e ftesës, nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka marrë pjesë në testin me shkrim, nga rrjedhë se ankuesi me vetë dëshirë e ka braktisur pjesëmarrjen në procedurën përkatëse të rekrutimit, dhe si rrjedhojë i njëjti nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative, dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.517/2025 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në nenin 44 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *10. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.*; dhe duke marrë për bazë konstatimin e më sipërm se ankuesi me vet dëshirë është tërhequr nga procedura e rekrutimit, gjegjësisht nga vlerësimi profesional i kandidateve, Kolegji i Këshillit, konstaton se të njëjtit nuk i është cenuar asnjë e drejtë në këtë procedurë rekrutimi, dhe si rrjedhojë Kolegji nuk është lëshuar në trajtimin e vlerësimit profesional nga testi me shkrim dhe intervista me gojë e kandidatëve pjesëmarrës nga kjo procedurë rekrutimi.

Kështu që, për sa me sipër, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmerinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.517/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, A.K.;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.